UDC: 327.3(100+4-672EU+497):323-022.326.5(497)
Review article

EUROPEAN UNION AND THE EUROPEAN PERSPECTIVE OF WESTERN BALKANS FROM STABILITY PACT TO BERLIN PROCESS, THE CASE OF ALBANIA

BASHKIMI EUROPIAN DHE PERSPEKTIVA EUROPIANE E BALLKANIT PERËNDIMOR NGA PAKTI I STABILITETIT TEK PROCESI I BERLINIT, RASTI I SHQIPËRISË

Zemaida MOZALI[1]

[1*] *Department of Political Sciences, Faculty of Social Sciences, University of Tirana*

Abstract

More than 30 years after the epochal changes in European continent, with the end of Cold war and the collapse of Yugoslavia, it seems rather strange that the countries of the Balkans are still in the 'pre-room' in the road towards European Union. Initially seen as SEE, including Albania, BiH, Bulgaria, Croatia, FRY, FYROM and Romania and later as Western Balkans, the region started immediately the process of EU integration, along with new countries coming from dissolution of Yugoslavia, after 1990. European Union responded immediately to the predisposition of the Balkan countries to be part of European family, by starting contractual relations with Albania at the first and with other countries subsequently, along with their detachment from FRY. European Union has provided many approaches and initiatives to the region, starting from Stability Pact, the Process of Stabilization and Association, followed by 2003 Thessaloniki summit as well as many other initiatives that have raised many expectations for the European future of the Balkans. The Berlin Process, a personal initiative of Mrs. Angela Merkel, was another solid brick in the wall of EU engagement in the region. There are many successes that these initiatives have brought, but the fact shows that today's Balkans is still on the way to 'reach' the EU, without having a concrete time for membership. This means an "unfinished business" on both sides.

Përmbledhje

Më shumë se 30 vjet pas ndryshimeve epokale në kontinentin Evropian, me përfundimin e luftës së Ftohtë dhe kolapsin e Jugosllavisë, duket mjaft e çuditshme që vendet e Ballkanit janë akoma në 'paradhomë' në rrugën drejt Bashkimit Evropian. Fillimisht i quajtur Europa Juglindore, duke përfshirë Shqipërinë, BiH, Bullgarinë, Kroacinë, RFJ, IRJM dhe Rumaninë e më pas Ballkani Perëndimor, rajoni filloi menjëherë procesin e integrimit në BE, së bashku me vendet e reja që erdhën nga shpërbërja e Jugosllavisë, pas vitit 1990. Bashkimi Europian iu përgjigj menjëherë predispozicionit të vendeve të Ballkanit që të bëheshin pjesë e familjes europiane, duke filluar marrëdhënie kontraktuale me Shqipërinë në fillim dhe me vendet e tjera më pas, gradualisht me shkëputjen e tyre nga Republika Federative e Jugosllavisë. Bashkimi Europian ka ofruar shumë qasje dhe iniciativa në rajon, duke filluar nga Pakti i Stabilitetit, Procesi i Stabilizimit dhe Asociimit, pasuar nga Samiti i Selanikut 2003 si dhe shumë iniciativa të tjera që kanë ngritur shumë pritshmëri për të ardhmen europiane të Ballkanit. Procesi i Berlinit, një iniciativë personale e zonjës Angela Merkel, ishte një tjetër tullë e fortë në murin e angazhimit të BE-së në rajon. Ka mjaft suksese që kanë sjellë këto iniciativa, por fakti tregon se Ballkani i sotëm është ende në rrugën për të 'arritur' në BE, pa patur një kohë konkrete për anëtarësim. Kjo do të thotë një "biznes i pa-përfunduar" nga të dy anët.

I. Pakti i stabilitetit mes retorikës dhe rezultateve konkrete

Ashtu si Europa pësoi një ndryshim dramatik pas ngjarjeve të 1989, mbas rënies së Murit të Berlinit, kështu mund të thuhet se edhe rajoni ynë ndryshoi rrënjësisht pas krizës së Kosovës. Pavarësisht marrëdhënieve pozitive dhe me rezultate konkrete sa i takon Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, viti 1997 shënoi një ngërc i cili u pasqyrua në ngrirjen e këtyre raporteve. Ndërkohë, në vitin 1996 Komisioni Europian kishte botuar një të ashtuquajtur 'White Paper', ku e përcaktonte Shqipërinë si një vend që duhet të ecte me ritmin e reformave, duke e vënë në një pozicion të favorizuar, bashkë me Maqedoninë, në krahasim me vendet e tjera të rajonit,[321]

Bashkësia ndërkombëtare nuk kishte arritur të pajtojë dy parimet që u përcaktuan si të paprekshme pas Luftës së Dytë Botërore: Sovraniteti kombëtar dhe e drejta e popujve për vetëvendosje. "Detyra për të ndërhyrë" u realizua shumë vonë nga ana e komunitetit ndërkombëtar dhe sidomos Bashkimi Europian, i cili ose u gjend i papërgatitur përballë një situate të tillë, ose sepse në politikën e jashtme, BE-ja ndiqte parimin e një diplomacie shumë të matur dhe jo-reaktive. Dhe kur ndërhyrja e ndërkombëtarëve u realizua, kishin ndodhur mizoritë nga milicitë serbe si dhe kishte filluar kriza e refugjatëve. Kosova dhe vendet fqinje të saj ishin zona të katastrofës që duhet të "stabilizoheshin" dhe rindërtoheshin sa më shpejt që të ishte e mundur. Ajo që po vihej tashmë në diskutim ishte stabiliteti europian, kredibiliteti dhe besueshmëria e projekteve evropiane.

Pakti i Stabilitetit ishte ndoshta përgjigjja e parë globale ndaj sigurisë rajonale, rindërtimit dhe zhvillimit në një rajon që konsiderohej tradicionalisht "baruti i Europës", siç e përkufizon Aurel Braun.[322] Ishte një veprim i bashkërenduar i BE-së, SHBA-së dhe partnerëve të tyre rajonalë për të krijuar parakushtet për krijimin e strategjive rajonale dhe masave konkrete në gjendje të sigurojnë udhëzimet për vendosjen e re të sigurisë në rajon. Përkundër të gjitha retorikave të udhëheqësve europianë, shumë argumentojnë se Pakti ka qenë pothuajse një projekt-letër.[323]

Shumë konferenca, takime dhe konsultime në nivele të ndryshme zyrtare dhe jozyrtare janë mbajtur në të gjithë rajonin dhe jashtë tij, por asgjë me substancë nuk po ndodhte vërtet. Ky proces duhet të çonte në tejkalimin e trashëgimisë së shpërbërjes, të konflikteve të përsëritura në hapësirën e Europës Juglindore. Procesi duhet të parandalonte përshkallëzimin e dhunës etnike, përdorimin e forcës ushtarake dhe spastrimit etnik nga forcat qeveritare kundër qytetarëve të tyre, një seri konfliktesh të përgjakshme që i kishin shkaktuar Ballkanit një numër të madh konsekuencash: viktima njerëzore, vrasje masive, valë të pafund refugjatësh dhe personash të zhvendosur, ndarje të thella etnike dhe fetare.

Misioni i Paktit ishte të punohej me përgjegjësinë më të lartë duke bërë bashkë partnerë rajonalë dhe bashkësinë ndërkombëtare për të zhvilluar një strategji të përbashkët për stabilitetin dhe rritjen e rajonit dhe për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin dhe donatorët kryesorë për të zbatuar atë strategji. Mbetet e diskutueshme nëse Pakti i përmbushi pritjet dhe nëse vërtet solli rezultate konkrete në rajonin për të cilin ishte ideuar, pra në Ballkan. Pavarësisht analizës dhe kriticizmit që i bëhet një iniciative të tillë, e cila solli pritshmëri të mëdha për rajonin, e rëndësishme ishte që te kishte një kuptim të drejtë të iniciativës. Ideja që të tilla ndërhyrje dhe strategji që ndërmerreshin nga faktori ndërkombëtar duhet të mbështeteshin nga komunitetet lokale. Sikurse shprehej Ambassador Robert Barry, Shefi i Misionit të OSCE në Bosnje Hercegovinë, në citin 1999.

---

[321] Marrë nga një prej intervistave me faktorët politikë 1992-2007, Dialogu Para – Antarësimit BE-Shqipëri, Bashkimi Europian, Ministria e Integrimit Europian, 2009, Tiranë, Shqipëri, fq. 83.

[322] Aurel Braun (1983): SMALL STATE SICURITY IN THE BALKANS: Complications from the West, fq.119.

[323] Shiko për më shumë INFORMATION NETWORK-SP Watch, Vol. 2, Issue 10, June 7, 2000, f. 10.

"Ne nuk duhet t'i lejojmë vetes tonë të besojmë se sfidat e ndërtimit të paqes, demokracisë dhe stabilitetit mund të zgjidhen vetëm nga presidentët dhe kryeministrat". Pra, duhet të vinte mbështetja nga vetë rajoni dhe jo thjesht iniciativa të imponuara apo të krijuara nga 'lart', pra nga faktori ndërkombëtar.[324] Arsyet e mos-pasjes së rezultateve konkrete në terren nga Pakti i Stabilitetit shpesh i referoheshin kushteve historike, të së kaluarës, mungesës së kulturës së demokracisë, si edhe ndikimeve kontradiktore sociale, kulturore dhe fetare të cilat dukshëm shënuan zhvillimet e rajonit; përsëri ekziston një tendencë për t'i përdorur këto si justifikime për mungesën e bashkëpunimit rajonal nën dritën e zhvillimeve të Paktit të stabilitetit.

Edhe më keq, ata shpesh shfrytëzohen për të mbështetur ideologjikisht forma të ndryshme ekstremizmi dhe nacionalizmi sesa si një gur themeli për të organizuar bashkëjetesën paqësore. Duke marrë në analizë këtë sipërmarrje të faktorit ndërkombëtar, në adresë dhe për llogari të vendeve të rajonit, ajo cka mund të nënvizohet është fakti se pa Kosovën dhe pa zgjidhur cështjen e Kosovës, qoftë stabiliteti, qoftë bashkepunimi, qoftë ecuria drejt anëtarësimit drejt Bashkimit Europian, do të ishte e pamundur.

Projekte apo vizione që kishin si qëllim të ofronin zgjidhje për sigurinë e përgjithshme të rajonit nuk mund të ishin eficente pa i dhënë drejtim cështjes kritike të Kosovës. Kjo mbetet si një gur prove jo thjesht për këtë iniciativë të ndërmarrë në korrik të 1999, por edhe për të tjera iniciativa që faktori ndërkombëtar do të ndërmerrte më vonë, me idenë se rajoni duhet ta kalojë si fillim sfidën e bashkepunimit rajonal dhe pastaj sfidën e integrimit europian.

Tre tryezat e Paktit të Stabilitetit: 1. Demokracia dhe të drejtat e njeriut; 2. Rindërtimi, zhvillimi dhe bashkëpunimi ekonomik dhe 3. Siguria, me dy tavolina pune të nënrenditura për siguri dhe mbrojtje si dhe drejtësi dhe punë të brendshme kishin si qellim të realizonin aktivitete me qëllim arritjen dhe institucionalizimin e dialogut ndërmjet vendeve të rajonit, të parandalonin konfliktet, të ndikonin në zhvillimin ekonomik dhe demokracinë e vendeve, si instrumente që do të ndikonin në parandalim, pajtim, rindërtim dhe zhvillim. Pavarësisht këtyre takimeve e marrëveshjeve të firmosura, pati mjaft probleme, nisur nga fakti që ndërkombëtarët i trajtojnë çështjet e vendeve të rajonit si diçka tipike për tranzicionin dhe jo për zhvillim. Kjo gjë ka cuar në shumë dështime.

Duke marrë vetëm një shembull të asistencës ekonomike dhe financiare, kushtet që një vend duhet të përmbushë në mënyrë që të plotësojë kerkesat e institucioneve financiare ndërkombëtare ishin shpesh kontradiktore me ato që duhet të plotësonte për llogari të vet. Konkretisht, stabilizimi dhe liberalizimi janë të vështirë për të vepruar në kontekstin e njërit apo tjetrit. Prandaj, perspektiva integruese e Europës Juglindore, në bazë të PS, duhet të ishte një "perspektivë reale", e cila duhet t'i përgjigjej popullsive dhe liderave politike të kohës.

II. Procesi i stabilizim asociimit

Deri nga viti 1999, politika integruese europiane në rajon kishte ecur në dy drejtime: Ai i Marrëveshjeve të Asocimit, apo Marrëveshjeve Klasike Europiane, ku ishin përfshirë dhe Rumania e Bulgaria[325], pra praktika tradicionale, si dhe Ai i „Përqasjes Rajonale", specifike për disa vende të Balkanit. Ky koncept i Përqasjes Rajonale përbënte një kuadër për zhvillimin e Marrëdhënieve me pesë vende të rajonit të Balkanit, me të cilat BE deri në fund të 1996 nuk kishte miratuar direktivat për hapjen e negociatave për marrëveshjet e asocimit. Ky fakt është analizuar nga shumë studjues, disa prej të cilëve e kanë parë edhe si një mungesë vëmendje dhe angazhimi serioz nga ndërkombëtarët për të ndërhyrë në problemet që kishte Ballkani.

---

[324] http://www.naa.be/publication/comrep/2000/at-096-e.html

[325] Përmendet shpesh se " Shqipërisë i iku në 1996 shansi që mund të kishte që të nënshkruante edhe ajo një Marrëveshje të tillë si ajo Europiane me vendet që sot janë anëtare të BE-së", nga diskutimi i z. Ditmir Bushati në një Seminar Trajnimi "Integrimi në BE" organizuar nga EMA, 04. 02. 2009

Pra, si mungesa e një strategjie parandaluese të konflikteve, apo edhe mosndërhyrja në kohë për zgjidhjen e tyre kishte sjellë përshkallëzimin e tyre deri në atë pikë sa shpesh herë situatat kanë qenë problematike (kujtojmë Kosovën 1999, Maqedoninë në 2001), si pasojë e efektit "domino", i cili siç mund të kuptohet edhe nga emri, sjell kalimin e efektit direkt nga njëra zonë në tjetrën. "Ndryshimet historike të vitit të kaluar hapën 'Kutinë e Pandorës', të konflikteve që duket se kishin "fjetur" për një kohë të gjatë. "Çdo gjë ka nevojë për vëmendje dhe të gjithë kanë potencialin të nxisin dhunën në një zonë më të ndërlikuar, pas rënies së Millosheviçit. Analistët dhe diplomatët, të cilët merren me zhvillimet në rajon, i konsiderojnë Serbinë, Malin e Zi, Kosovën dhe Maqedoninë si vende të cilat duhet të vëzhgohen dhe trajtohen me vëmendje", reflektonte në mënyrë kritike Andrew Gray.[326]

Por, nga ana tjetër, studjuesit dhe analistët politikë sjellin në vëmendje edhe mangësitë e vetë vendeve të Ballkanit, të cilat nuk kanë ditur të përdorin mundësitë e ofruara nga BE dhe organizmat ndërkombëtare, në momente të caktuara.[327] "Sigurisht, te tjera goditje "skene" janë të mundshme. Shumë dykuptimësi peshojnë në sjelljen e Beogradit. Dhe "vrimat e zeza" ballkanike, nga Kosova në Mal të Zi, nga Bosnja në Maqedoni, qëndrojnë kërcënuese. Por ky është momenti që ti japim një shans Ballkanit", shkruan Federico Fubini, duke komentuar rreth Perëndimit.[328]

Ka mjaft debate të kohës se, veçanërisht duke marrë parasysh zhvillimet në Kosovë dhe rajon, BE-ja nuk kaloi me sukses 'provën e reagimit' apo edhe 'parandalimit' në një rajon që edhe pse nuk ishte institucionalisht pjesë e tij, ishte në procesin e anëtarësimit në Europën e bashkuar. Ky moment historik dhe reagimi i BE-së si një 'fuqi e butë' dhe jo me ndërhyrje ushtarake, vazhdon të jetë objekt analize dhe interpretimesh, duke sjellë nevojën e një rishikimi të vizionit dhe misionit të saj në politikën e jashtme.[329]

Rajoni i Ballkanit kishte nevojë të arrinte rezultate në pajtim, stabilizim, fqinjësi të mirë, bashkëpunim rajonal. Në librin e tij rreth civilizimeve dhe komunikimit mes kulturave, Dieter Senghaas e konsideron zhvillimin e Evropës, si jo të ekuilibruar, në disa pjesë më të zhvilluar se në të tjerat, dhe shtron si nevojë transformimin e saj historik, politik, ekonomik dhe kulturor. Ai e sheh rindërtimin e Evropës si një periudhë të zgjatur të emancipimit, e cila "madje edhe në periudhën më të mirë nuk është përfunduar ende sot".[330]

E nëse për analogji, do t'i referohemi rajonit të Ballkanit dhe nevojës së tij për transformim, duket se periudha e nevojshme për t'u zhvilluar, rindërtuar, transformuar dhe emancipuar duhet të jetë shumë më e zgjatur se ajo e vetë Evropës. Tre vjet pas miratimit të Përqasjes Rajonale, nën dritën e zhvillimeve në Kosovë e në rajon, BE u bind për nevojën e përcaktimit të një përqasje të re, më dinamike, më të avancuar. Ishin konfliktet në Ballkanin Perëndimor gjatë viteve 90-të dhe pasojat e luftrave në këtë rajon që bënë imperative që vëmendja e Bashkimin Europian të përqëndrohej në vendosjen e stabilitetit dhe prosperitetit në rajon.

Kështu, gjatë Samitit të Zagrebit (nëntor 2009) të udhëheqësve të BE-së, dhe të vendeve të Ballkanit Perëndimor, përfaqësuesit e rajonit konfirmuan angazhimin e tyre të plotë në Procesin e Stabilizim Asocimit (PSA), një strategji e lidhur qartë me perspektivën e hyrjes në BE dhe që i përshtatej nivelit të zhvillimit të secilit nga vendet në fjalë. Sikurse bëhet i qartë nga vetë emri, PSA ka për objektiv përfundimtar përgatitjen e pesë vendet e Ballkanit

---

[326] Andrew Gray: *Balkan Is Still Endangered*, SHEKULLI newspaper, 20/12/2000.

[327] Po aty.

[328] La Serbia serbata, tek *I Balkani senza Milošević, Come cambia la Jugoslavia, I misteri del Kosovo, Una chance per l'Italia*, RIVISTA ITALIANA DI GEOPOLITICA, LiMes, 5.2000 Gruppo Editoriale l'Espresso, 2000

[329] Për një analizë të plotë mund të konsultoni: Klodiana Beshku, Komuniteti/Bashkimi Europian dhe sfidat e shpërbërjes së Ish-Jugosllavisë në fillim të viteve Nëntëdhjetë, (2018), *Shtetformimi, Demokratizimi & Europianizimi i Ballkanit \Perëndimor*, Edlora, Tiranë

[330] Dieter Senghaas, 2002, The realistic reconstruction by Westerners of their own historical development, *The clash within civilizations*, Routledge

Perëndimor për anëtarësim, por kjo nuk zëvendëson procedurat e antarësimit. Procesi është platformë pune me masa të ndërmarra, me programe, konsulenca teknike, preferencat tregtare, bashkëpunimi në fusha si drejtësia, punët e brendshme si edhe dialogu politik-lehtësojnë zhvillimin politik dhe ekonomik, për të përgatitur vendet e Ballkanit Perëndimor për një formë të re marrëdhënieje kontraktuale, e përshtatshme për pesë vendet e rajonit. Ky tip i ri u quajt Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit.[331] Këta marrëveshje synonin të sillni një dimension të ri në ato vende që nuk e kishin arritur këtë nivel , duke zhvilluar marrëdhënie më të avancuara me të tjerat që i kishin.[332]

Sikurse kuptohet lehtësisht në emër, një element i ri i këtij procesi të ri, ishte koncepti i procesit të stabilizimit, i cili vjen si një parakusht para asociimit/shoqërimit. Termi PSA është zgjedhur jo pa qëllim dhe është treguar mjaft kujdes në përcaktimin e tij. Midis stabilizimit dhe asocimit duhet vendosur ekuilibri i duhur, pra nuk mund të asociohesh pa qenë një vend i stabilizuar. Të dy elementët përshkruajnë atë çfarë BE synon të arrijë dhe që duhet të ecin paralel. Por një mësim i qartë ka dalë: "Vështirë se ecet shumë larg drejt asocimit po të mos ketë një farë shkalle stabiliteti, veçanërisht respekt për shtetin e së drejtës dhe funksionimin e institucioneve politike e juridike."[333] Dhe për të argumentuar këtë përfundim, merreshin dy shembuj, Kroacia dhe Maqedonia. E para, kishte një maturi më të madhe institucionale dhe administrative kur hyri në PSA dhe kjo përcaktoi ecurinë e saj të shpejtë. Ndërsa për Maqedoninë opinioni i Komisionit ishte se "ndoshta ishte e nxituar hyrja në negociata për MSA, pa i kushtuar më parë kohën e duhur ndërtimit të bazave të nevojshme për zbatimin e saj efektiv„.

III. Shqipèria mbas 1990

Si vendi i parë që filloi marrëdhënien kontraktuale me Bashkimin Europian, Shqipëria duhet të tregonte seriozitet dhe përkushtim, pasi po kalohej nga diktatura në demokraci. Kjo e bënte të veshtirë tranzicionin në një system i cili jo thjesht nuk kuptohej sa duhej, por që ishte e veshtirë të përvetësohej, për arsye të trashëgimisë së kohës së diktaturës. Pavarësisht kësaj, Shqipëria arriti të kishte një raport dhe bashkëpunim të frutshëm me BE-në. Shqipëria ishte vendi i pare në rajon që nënshkroi marrëdhënie kontraktuale më Bashkimin Europian dhe filloi menjëherë përpjekjet për të qenë pjesë e programeve dhe projekteve të ofruara nga Bashkimi Europian. Shqipëria arriti mjaft mirë të përfitonte nga këta programe dhe projekte.

Që prej vitit 1991 Shqipëria ka përfituar nga asistenca e BE-së rreth 1 milardë e 50 milionë euro, duke nënvizuar edhe faktin që Marrëveshja e nënshkruar me Bashkimin Europian ishte asimetrike dhe i ofronte lehtësira palës shqiptare. 85 milionë euro të përfituara ishin kredi nga Banka Europiane e Investimeve dhe pjesa tjetër, grant. Midis viteve 1991 - 1993, rreth 318 milionë euro iu ofruan Shqipërisë si ndihma emergjence dhe ushqimore. Nga viti 1994- 1996, programi Phare ka ofruar rreth 190 milionë euro, si mbështetje për reformat ekonomike.[334]

Pavarësisht mbështetjes së dhënë nga Bashkimi Europian, pavarësisht se kishte mjaft vende që e shikonin me admirim zhvillimin dhe dinamikën e ndryshimeve të Shqipërisë, asnjë nuk mund ta para-mendonte që rruga e anëtarësimit do të zgjatej e stërzgjatej pa fund. Në një intervistë në lidhje me dialogun e para-anëtarësimit BE-Shqipëri, Aleksandër Meksi përpiqet të gjejë arsyet e kësaj zgjatje apo zvarritje të rrugës drejt anëtarësimit, duke e krahasuar me një

---

[331] Shih: MARRËDHËNIET E BASHKIMIT EUROPIAN ME SHQIPËRINË, Delegacioni i Komisionit Europian në Shqipëri, Doc. Botuar në Qershor 2006. Përveç botimit, shih dhe www.delalb.cec.eu.int

[332] Përbërja e Procesit, *[Komunikim i Komisionit ref. COM (99)*235 dt. 26.05.1999]

[333] Paskal MILO, 2002: BASHKIMI EUROPIAN, *Ideja, Integrimi, Identiteti, E ardhmja, Shtëpia Botuese "ALBPAPER*", Tiranë.

[334] Të dhënat janë marrë nga Banka e Shqipërisë, në një punim nga Znj. Ermelinda Meksi, Ministre e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë gjatë periudhës dhjetor 2003 deri në shtator të vitit 2005

tren "I cili ecën shpejt dhe që është treni europian. Kapim dorezën tek ai, por nëse nuk vrapojmë dhe ne me atë ritëm, ai na heq zvarrë". Mesazh ky, i cili është i vlefshëm për të gjitha periudhat, për të gjitha qeveritë, duke e bërë të qartë se pavarësisht se qeveritë kanë përgjegjesinë kryesore në menaxhimin e proceseve integruese, këta procese nuk janë "pronë" e vetëm askujt. Opozita, vetë shoqëria shqiptare, dukej se ishte e papërgatitur për vështirësitë dhe sfidat që e prisnin në këtë rrugë sa të vështirë, aq edhe interesante.[335]

Nëse do kërkonim arsye të kësaj stërzgjatje të procesit të antarësimit, patjeter që do kishte vend për analizë të vetë Bashkimit Europian, zhvillimeve të brendshme, ngritjeve dhe uljeve, zgjerimeve me anëtarë të rinj dhe ndryshimet që sjellin këta zhvillime edhe në qasjen e vetë BE-së në raport me vendet e rajonit. Por, duke dashur të jemi objektivë dhe realistë, është më e saktë të gjejmë arsyen tek 'the local ownership, apo pronësinë lokale', e cila përkthehet në përgjegjësi, seriozitet, përkushtim, të vetë shoqërisë shqiptare për ta bëre këtë process të mundshëm dhe me arritje konkretë.

Kjo, si nga pikëpamja teknike, por sidomos nga pikëpamja politike, ku politika ka rol mjaft të rëndësishëm në këtë process të ndërlikuar. Vazhdon të mbetet një mungesë përgjegjësie apo gabim nga ana e politikaneve prezenca e korrupsionit. Por, vullneti për të mos e luftuar dhe mungesa e ndëshkueshmërisë, e cila ka gjetur vend në kulturën tonë, është më problematike. Aktualisht Shqipëria po bën hapa në lidhje me reformën në drejtësi, e cila mendohet të japë rezultate, pavarësisht skepticizmit nga ana e popullatës.

Shoqëria shqiptare, përfshi politikën, ka një varësi të dukshme nga komuniteti ndërkombëtar. Në raste krizash të brendshme, faktori ndërkombëtar duhet të ndërhyjë me patjetër për zgjidhjen e tyre, gjë që konfirmon një kulturë varësie si dhe faktin që tranzicioni demokratik nuk është i përfunduar. Në vitin 2011, megjithëse Shqipëria ishte anëtare e NATO-s dhe kishte aplikuar për anëtarësim në Bashkimin Europian, u gjend para një krize të re, për të cilën Brukseli dhe Washingtoni duket se kishin nevojë të ndërhynin, duke përsëritur episode të ngjashme gjatë viteve të tranzicionit.[336]

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit midis Shqipërisë dhe BE-së ka hyrë në fuqi në prill 2009 dhe Shqipëria ka vazhduar me plotësimin e kritereve të antarësimit, me gjithë problemet që e shoqërojnë. Për sa u përket kritereve politike, mjedisi politik në Shqipëri vazhdon të shënjohet nga një polarizim intensiv, gjë që tregon se politika shqiptare është akoma e pamaturuar. Po ashtu, administrata publike ka përgatitje të moderuar, gjë që u paraqit edhe në Progres Raportin e fundit të Komisionit Europian. E njëjta gjë thuhet edhe për sistemin gjyqësor, me një lloj niveli përgatitjeje/është i përgatitur në mënyrë të moderuar.[337]

Pavarësisht problemeve të shumta, të cilat më së shumti janë probleme të brendshme dhe faktit që shpesh herë demokracia është shumë larg konsolidimit, më 25 mars 2020**,** Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE-së vendosi të hapë negociatat e anëtarësimit me Republikën e Shqipërisë, ndërkohë që më 26 mars 2020, Këshilli Europian miratoi vendimin e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme të BE-së për hapjen e negociatave me Shqipërinë.[338] Ndërkohë ndihma bilaterale e BE-së për Shqipërinë nën Instrumentin e Ndihmës së Para-Anëtarësimit (IPA II) në vitet 2014-2020 arrin në 758 milion EUR. Programet e veprimit 2019 dhe 2020 përfshijnë një kontribut të BE-së në vlerë prej 173.95 milion EUR.

---

[335] Dokumenti sjell intervista nga të gjithë protagonistët politikë për periudhën 1992-2007, qofshin ata shqiptarë, qofshin të huaj, duke iu referuar marrëdhënieve me Brukselin si edhe të gjitha vështirësive, por edhe arritjeve të deriatëhershme. Dialogu Para – Antarësimit BE-Shqipëri, Bashkimi Europian, Ministria e Integrimit Europian, 2009, Tiranë, Shqipëri

[336] Shiko për më shumë Stopping The Spiral To The Abyss at Tirana Times February 2011, vol.7 Nr. 400

[337] Progres Raporti Final i Komisionit Europian (tetor 2020), Republika e Shqipërisë, Kuvendi, https://www.parlament.al/DokumentaIntegrimi?integrimId=2

[338] Azhornuar nga Ministria e Integrimit dhe Punëve të Jashtme (2021), *Historiku i Marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian- Datat dhe momentet historike*, http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/

Sipas informacioneve më të detajuara, kjo mbështetje financiare shkon përmes operacioneve të mbështetjes së buxhetit, përfshirë reformën në drejtësi.[339]Kjo ndihmë financiare e konsiderueshme dhe e nevojshme për zhvillimin ekonomik dhe politik, qe mbështet konsolidimin e demokracisë dhe plotësimin e kritereve të antarësimit, kërkon seriozitet dhe përgjegjshmëri në menaxhim nga të gjithë faktorët Duhet shumë punë, seriozitet dhe përfshirje e të gjithë faktorëve që ndikojnë në zhvillimin e mëtejshëm të procesit të integrimit, që ndoshta për vendin tonë rrezikon të jetë i largët.

IV. Procesi i Berlinit

Nëse mbas vitit 1990 vendet e Ballkanit nuk kishin alternativë tjetër përvec BE-së, pas vitit 2000 situata gjeopolitike kishte ndryshuar dhe në skenën e rajonit po dilnin ne pah forca dhe interesa të tjera. Ishte momenti kur vetë Bashkimi Europian gjendej përpara vështirësive, situatave të paparashikuara dhe të vështira për t'u menaxhuar. Në të tillë realitet, me probleme të brendshme dhe të jashtme jo të favorshme, edhe vëmendja ndaj rajonit dukej e zbehur, duke i lënë vend vendeve si Rusia, Kina apo Turqia që të ushqenin idenë e prezencës dhe influencws së tyre nw rajon dhe krijimit të alternativave të tjera tw mundshme përvec se Bashkimit Europian".[340]

Premtimet e BE-së për të ardhmen europiane të vendeve të Ballkanit, që prej Samitit të Selanikut 2003, duhet të mbështeteshin me një iniciativë të re, në një kontekst gjeopolitik të ri, ku dukej se pro-europianizmi dhe dinamika e rajonit po zbehej, duke reflektuar në këtë mënyrë pa-mundësinë e vetë Bashkimit Europian për t'i ofruar afate konkrete këtyre vendeve në rrugën e antarësimit. Në një situatë të tillë, në vitin 2014, Kancelarja gjermane Angela Merkel inicioi të ashtuquajturin Procesi i Berlinit, me fokus vendet e Ballkanit Perëndimor dhe me qëllim që të rizgjonte dinamikën e përgatitjes së tyre për antarësim si edhe të rikonfirmonte vullnetin e Bashkimit Europian dhe mbështetjen ndaj rajonit.[341]

E parë në një spektër më të gjerë, kjo iniciativë, përvec mbështetjes dhe vëmendjes që i jep vendeve të rajonit, në një moment kur ishte e nevojshme kjo mbështetje, por mbeshtet njëkohësisht edhe kredibilitetin e BE-së, e cila kishte deklaruar pamundësinë e një zgjerimi të radhës me vendet e rajonit. Procesi i Berlinit, 2014 – 2018, përfshin vendet e BP dhe Gjermaninë, Francën, Austrisë, Italinë, Slloveninë dhe Kroacinë, si dhe Komisionin Europian dhe institucionet financiare ndërkombëtare. Procesi ka si qëllim kryesor të mbajë të motivuar elitat politike të vendeve të rajonit si edhe qytetarët në vazhdimin e reformave të nisura, për ta sjellë rajonin sa më afër qëllimit final të antarësimit.

---

[339] Po ashtu, për të mbështetur rimëkëmbjen pas tërmetit nëntor 2019, 115 milion EUR janë dhënë për rindërtimin e shkollave dhe rehabilitimin e vendeve të trashëgimisë kulturore. Kjo mbështetje financiare e ardhur nga BE-ja ka fektin e vet në arritjen e standarteve të kerkuara dhe vendosura për vazhdimin e plotësimit të kushteve për antarësim. Si pjesë e përgjigjes ndaj pandemisë COVID19, 4 milion EUR janë rifokusuar për pajisje urgjente mjekësore dhe 46.65 milion EUR për masat e rimëkëmbjes socio-ekonomike nën IPA II.
Informacion i marrë nga Raporti për Shqipërinë i Komisionit Europian 2020, Brussels, 6.10.2020 SWD (2020) 354 final, tek https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf

[340] Për një analizë më të të hollësishme të gjeopolitikës dhe aktorëve të interesuar dhe të përfshirë në rajonin e Ballkanit, mund të konsultoni Florian Bieber and Nikolaos Tzifakis, (2019) The Western Balkans are drifting aëay from their Euro-Atlantic orientation, *The Western Balkans as a Geopolitical Chessboard? Myths, Realities and Policy Options,*BiEPAG Policy Paper,

[341] Ballkani Perëndimor, i cili në vazhdim do të përdoret me shkurtimin BP është një term gjeopolitik i ideuar nga organet drejtuese të Bashkimit Europian në fillim të viteve 2000, duke iu referuar atyre vendeve në Evropën Jug-Lindore që ishin jo anëtarë ose kandidatë të BE në atë kohë, por mund të aspironin të bashkoheshin në bllok. Fillimisht, Rajoni i Ballkanit Perëndimor përbëhej nga shtatë vende - Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia - por Kroacia tashmë është bashkuar me BE-në.

Një proces kryesisht me karakter politik, me dimension ekonomik dhe social, bën bashkë një sërë fushash dhe çështje të bashkëpunimit rajonal, çështje bilaterale dhe çështje të tjera që lidhen me transportin, energjinë, qeverisjen e mirë, rininë, migracionin, tregëtinë, ekologjinë dhe së fundmi sundimin e ligjit. Në katër vitet e para të këtij procesi u zhvilluan pesë samite dhe pati takime, aktivitete me pjesëmarrje të personaliteteve të niveleve të larta dhe jo vetëm, ku janë prezantuar mbi 50 projekte në fusha të ndryshme. Procesi në fjalë, nuk ishte krejt i qartë që në fillimin e tij, nisur nga fakti se nuk ka asnjë përkufizim të pranuar gjërësisht apo një shpjegim zyrtar se çfarë është ekzaktësisht.

I nisur me qëllimin e mbajtjes së ritmit të përgatitjes së vendeve të rajonit pëe plotësimin e kushteve të antarësimit, ky process duket shumë kompleks dhe shumëdimensional. Procesi i Berlinit, në thelb, është një riformulim i qasjeve ekzistuese, të reklamuara në mënyra të ndryshme. Nuk është krijuar për të nxitur ndryshime rrënjësore, as për të zëvendësuar ata ekzistuese, por thjesht për të dhënë shtysë për qasjet e ndjekura deri atëkohë. Procesi nuk ka krijuar *acquis* të ri, as institucione të reja. Fakti që Procesi nuk ka një buxhet të vetin, e bën të krahasueshëm nga pikëpamja financiare me nismën e sipërtrajtuar, atë të Paktit të Stabilitetit për Europën Juglindore.

Kjo e fundit, krahasohej me Planin Marshall të pasluftës së dytë botërore, me ndryshimin e madh se Plani Marshall iu ofrua Europës si një grant nga Shtetet e Bashkuara. Po ashtu, një ndryshim sinjifikant ishte natyra unilaterale e Planit Marshall, ndërkohë që Pakti i Stabilitetit si edhe Procesi i Berlinit kanë natyrë multilaterale, duke përfshirë një gamë të gjerë aktorësh dhe faktorësh, qeveri vendesh aspirante, qeveri vendesh anëtare të Bashkimit Europian, institucione financiarë, organizata joqeveritare dhe qeveritare dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile.

Kjo nisëm europiane në misionin e vet ka bashkëpunimin rajonal. Për rajonin e Ballkanit, bashkëpunimi është parakusht për antarësim dhe Procesi i Berlinit ne aktivitetet, deklaratat, iniciativat, ka si qëllim nxitjen e këtij bashkëpunimi. Pra bëhet e qartë se Procesi nuk është zëvendësues i antarësimit, sikurse e interpretojnë disa analistë dhe komentues, por plotësues dhe mbështetës i tij, sikurse e deklaroi Komisioneri Várhelyi në takimin e ministrave të jashtëm të Procesit të Berlinit "Unë e mirëpres faktin që takimi i sotëm do të përqendrohet në rëndësinë e bashkëpunimit rajonal. Nuk është një alternativë ndaj integrimit në BE por një pjesë themelore e procesit që çon në të".[342]

"Mbivendosja e Procesit të Berlinit në matricën aktuale të bashkëpunimit rajonal rrezikon të "shkeli mbi këmbët" e nismave të tjera ekzistuese".[343] Për të evituar çdo mundësi të dyfishimit të kompetencave, përfaqësuesit e vendeve të Ballkanit Perëndimor kanë pohuar se, në kuadër të Procesit të Berlinit, qeveritë e tyre do të veprojnë në komplementaritet dhe sinkronizim paraprak me nismat e themeluara më herët. Në të njëjtën kohë, duhet të evitohet paqartësia, pasi kur futen shumë akttorë në lojë, krijohet konfuzion dhe bëhet e vështirë të dihet 'kush bën cfarë'.

V. Shqipèria dhe procesi i Berlinit

A ka përfituar Shqipëria nga Procesi i Berlinit dhe nëse po, cilat kanë qenë realizimet konkrete? Pa dashur të përsërisim ato cka përmendëm, mekanizmi i financimit të programeve dhe projekteve të paraqitura në kuadër të kesaj iniciative, është kompleks dhe ndërlikuar. Kjo pasi ka projekte dhe investime që mund të jenë financuar nga mbështetja financiare e BE-së në formë grantesh, apo edhe institucioneve të tjera financiare ndërkombëtare, por që në rastin

[342] Marrë nga fjala e Komisionerit Oliver Várhelyi në takimin e ministrave të jashtëm të Procesit të Berlinit, 9 nëntor 2020, Komisioni Europian, https://ec.europa.eu/commission/commissioners/2019-2024/varhelyi/announcements/remarks-commissioner-varhelyi-berlin-process-foreign-ministers-meeting_en

[343] Ardian Hackaj et al, (2015) "Shqipëria në Procesin e Berlinit: Arritjet aktuale dhe sfidat e Samitit të Parisit", Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim / ShtetiWeb, fq 27, Tiranë

konkret janë realizuar në kuadër të procesit. Megjithatë, koordinimi i të gjithe aktorëve që prezantojnë programet dhe atyre që i financojnë ata, krijon një farë paqartësie të skemës së funksionimit. Sipas Hackaj, Western Balkans Investment Framework mbledh burimet dhe ekspertizën e palëve të interesuara për të financuar projekte dhe për të forcuar koordinimin midis donatorëve dhe përfituesve në vendet e Ballkanit Perëndimor. Një skemë e tillë funksionon që prej fillimit të procesit dhe ndihmon në realizimin e projekteve infrastrukturore, qoftë "mbi bazën e nevojave rajonale dhe/ose të vendit, si dhe konsistencën e tyre me prioritetet e anëtarësimit në BE".

Një shembull i kësaj qasjeje ka qënë përmirësimi i infrastrukturës rurale. Po ashtu, referuar studimit të sipërcituar, "në Vjenë, Shqipërisë iu aprovua për bashkë-financim vetëm një projekt, linja e interkonjeksionit 400 kV Elbasan – Manastir. Ky përbën projektin energjetik më të rëndësishëm dhe kosto e parashikuar është 129 milion euro. Investimi në territorin shqiptar i linjës së transmetimit kushton 70 milion euro; 80% e vlerës është në formë kredie dhe do të mbulohet nga Banka Gjermane për Zhvillim – KfW, ndërsa pjesa tjetër prej 20% do të mbulohet në formë granti nga IPA II".[344]

Mbetet gjithnjë për të parë me realizëm sa dhe si do të realizohen projektet në fjalë, pasi mendohet se vendet e rajonit kanë premtuar më shumë se sa mundet të absorbojnë dhe zbatojnë. Po ashtu, në Samitin e Triestes, Shqipëria fitoi mbështetje për 5 projekte, konkretisht: Rindërtimi i kalatave 1 dhe 2 në portin e Durrësit; Ndërtimi i by-pass-it të Lezhës; Mbështetje për zhvillimin e hidrocentralit të Skavicës, një nga veprat më të mëdha energjetike të vendit dhe të Ballkanit Perëndimor; Projekti rajonal i sektorit energjetik për linjën e transmetimit me OST.[345]

"Lidhshmëria është më shumë se pajisje të reja transporti dhe energjie. Infrastrukturat ndërkufitare kanë kuptim nëse ato plotësohen nga reformat që lejojnë njerëzit dhe bizneset të marrin përparësinë e plotë të lidhjeve të transportit dhe energjisë", shprehet Johannes Hahn, duke e bërë edhe një herë të qartë se lidhja në infrastrukturë dhe transport i shërben lidhjes mes njerëzve (konektiviteti ose ndërlidhja, si një nga tre shtyllat kryesore të Procesit të Berlinit), afërsisë mes tyre dhe bashkëpunimit rajonal."[346] Simbolika e këtyre projekteve është e qartë: sa më shumë pajtim dhe afrim me njëri tjetrin, aq më shumë transformohet rajoni dhe më e afërt bëhet perspektiva europiane.

VI. Nè vend tè konkluzioneve

Nuk ka dyshim që integrimi në Bashkimin Europian ka qenë dhe mbetet objektivi final dhe kryefjala e programeve të të gjitha qeverive të vendeve të rajonit, që mbas vitit 1990. Në të njëjtën kohë, Bashkimi Europian e ka mirëpritur Shqipërinë fillimisht dhe më vonë rajonin, duke i ofruar një perspektivë europiane. Gjatë këtyre viteve ka patur një numër shumë të madh iniciativash me qëllim transformimin dhe përafrimin gradual të vendeve të rajonit me kriteret e antarësimit, të cilat kanë ndryshuar me kohën, duke bërë që vendet aktualisht anëtare të Bashkimit Europian të kalonin nëpërmjet proceseve të asociimit, apo firmosjes së të ashtuquajturave Marrëveshje Europiane ose Marrëveshje të Asociimit, ndërkohë që Shqipërisë dhe vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor i iku mundësia dhe kësisoj duhet të kalonin

[344] Po aty, fq 21.

[345] Marrë nga raporti i znj. Majlinda Dhuka, Drejtore e Departamentit i Zhvillimit dhe Ndihmës së Huaj, në konferencën për shtyp të Kryeministrit Edi Rama, Samiti i Triestes, përfitimet e Shqipërisë në Procesin e Berlinit, https://kryeministria.al/neësroom/samiti-i-triestes-perfitimet-e-shqiperise-ne-procesin-e-berlinit-2/

[346] — Johannes Hahn, European Commissioner for Neighbourhood Policy and Enlargement Negotiations, European Comission,(2018), CONNECTIVITY AGENDA *Co-financing of Investment Projects in the Ëestern Balkans 201*, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/connectivity-agenda-2018-sofia-summit.pdf

nëpërmjet procesit që kishte si parakusht stabilizimin dhe pastaj asociimin. Nisma të ndryshme tematike janë shfaqur në rajon që prej Paktit të Stabilitetit, me qëllim ndërtimin e lidhjeve të forta midis vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe për të lehtësuar bashkëpunimin njerëzor dhe profesional në fushat me interes të përbashkët. Pavarësisht emërtimit dhe misionit, të gjitha kanë si element thelbësor bashkëpunimin rajonal, i japin kohë vendeve të rajonit te demonstrojnë vullnet të fqinjësisë së mirë dhe për këtë mbështeten nga Bashkimi Europian, i cili, sidomos referuar zgjerimeve të fundit, duhet thënë se e ka zmadhuar 'lupën' dhe kërkesën e llogarisë ndaj vendeve aspirante.

Përtej vullnetit të mirë nga ana e BE-së, një prej problemeve që konstatohet ka të bëjë me mekanizmin e funksionimit, i cili shpesh herë është i komplikuar dhe burokratik. Të dy palët, si donatorët si përfituesit mund të ankohen: Nga ana e donatorëve, procedurat burokratike dhe kërkesat që i vihen vendeve përfituese janë në kundërshtim me mundësitë e këtyre të fundit për ti plotësuar.[347] Përveç kësaj, për arsye të natyrës së problemeve që Ballkani paraqet, e gjithë bota, që do të thotë komuniteti ndërkombëtar, direkt apo indirect është e përfshirë.

Eksperienca e Ballkanit paraqet një shembull instruktiv se si arkitektura ndërkombëtare vihet në veprim. Qartësisht, ajo ka një numër mangësish, të cilat janë rezultat i faktit që ka shumë "principale" dhe shumë "agjentë" dhe, me të vërtetë, në shumë zona themelore të veprimtarisë ndërkombëtare dallimi mes principalëve dhe agjentëve nuk është i lehtë për tu përcaktuar dhe si rezultat dalin shumë probleme.

Angazhimi politik i BE-së ka vazhduar në mënyrë të pandërprerë pas Samitit të Zagrebit edhe në Kosovë. Kosova është dhe do të vazhdojë të mbetet në vëmendjen e BE edhe në të ardhmen, jo thjesht për nga angazhimet që rrjedhin nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit , por edhe nga vetë procesi i Stabilizim-Asocimit, si një strategji rajonale europiane. Kosova ka sfida të shumta përpara për të përballuar, por më e madhja dhe më e rëndësishme është përfundimi me sukses i procesit të njohjes së pavarësisë, e njohur deri më sot nga 117 shtete. Është për të ardhur keq kur sheh reagimin e ashpër dhe aspak europian të Serbisë e cila, ndërkohë që është e 'imbarkuar, në rrugën e antarësimit, tërheq edhe ambasadorët e saj nga vendet që kanë njohur pavarësinë e Kosovës si një formë presioni.

Po ashtu edhe incidentet e ndodhura në kufirin me Kosovën, janë një tregues i qartë se dialogu mes Kosovës dhe Serbisë i lehtësuar nga BE-ja, nuk po sjell rezultatet e shumëpritura të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë mes dy vendeve si dhe avancimin e tyre drejtë BE-së. Nga ana tjetër edhe fakti që akoma edhe sot Kosovës nuk i janë liberalizuar vizat me BE-në, sikurse pjesës tjetër të rajonit, mund dhe duhet të ishte një angazhim nga ana e BE-së në kuadër të iniciativave mbështetëse të rajonit. Bashkimi Europian duhet të sigurojë barazi mes palëve gjatë krejt procesit të përafrimit dhe integrimit, pasi vetëm trajtimi i palëve si të barabarta e bën procesin të qëndrueshëm dhe arritshëm.

Po ashtu, për arsye të mënyrës se si merren vendimet, në shumë raste, nuk është transparente se kush janë ata që bëjnë axhendën në kontekstin ndërkombëtar. Për këtë arsye, nuk është gjithmonë e qartë cilat janë qëllimet dhe objektivat dhe cilët janë instrumentet që janë më të përshtatshme për të arritur objektivat e dëshiruara. Kjo e bën të vështirë për të përcaktuar cili funksion i objektivit është plotësuar dhe kësisoj errëson ndryshimin mes principaleve dhe agjentëve në kontekstin e veprimit ndërkombëtar.

Gjithashtu, ndonëse rikonstruksioni dhe zhvillimi ishin qëllimet e angazhimit ekonomik ndërkombëtar, shpesh here krijohen ekonomi të varura nga ndihma. Për më tepër, shpesh herë harrohet se çdo vend ka një potencial të limituar për të absorbuar. Dhe kjo duhet konsideruar, në mënyrë që të evitohen konfuzionet dhe të evitohet ajo që mund të konsiderohet "sindroma e varesise", duke bërë që shpesh vendet të kthehen në pritëse të granteve që vijnë nga donatorë të ndryshëm dhe kjo në një farë mënyre paralizon iniciativën e tyre per vetërealizim.

---

[347] South-East European Information Network, Stability Pact Watch, Volume 2, Issue 10, June 7, 2000.

Mbetet me rëndësi të qartësohet 'kush bën cfarë' tek roli dhe funksioni i iniciativave të ndryshme të ndërmarra në kohë të ndryshme me target rajonin e Ballkanit. Këta nisma nuk përjashtojnë njëra tjetrën por, në mënyrë që të mos ketë inflacion si edhe të mos ketë mbivendosje, eshtë me shumë rëndësi të ketë transparencë, informacion të vazhdueshëm, në mënyrë që të evitohen mbivendosjet dhe të ketë një koordinim të suksesshëm të tyre. Duke ofruar një perspektivë të qartë të zgjerimit me vendet e rajonit, Komisioni Europian (2018)[348] i mëshonte faktit se të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor tani duhet të dyfishojnë përpjekjet e tyre urgjente, të adresojnë reformat jetësore dhe të përfundojnë transformimin e tyre politik, ekonomik dhe shoqëror, duke sjellë të gjithë palët e interesuara nga i gjithë spektri politik dhe nga shoqëria civile.

Anëtarësimi në BE është shumë më tepër sesa një proces teknik, është një zgjedhje gjeneratash, bazuar në vlerat themelore, të cilat secili vend duhet të përqafojë në mënyrë më aktive, nga politikat e tyre të jashtme dhe rajonale e deri te ato që mësohen fëmijët në shkollë. Së fundmi, Bashkimit Europian dhe shtetet anëtare duhet të demonstrojnë fleksibilitet dhe gatishmëri për t'iu përgjigjur së pari vullnetit të vazhdueshëm dhe së dyti përpjekjeve të rajonit për tu bashkuar me familjen e madhe Europiane. Bashkimi Europian duhet të ofrojë perspektivë reale për vendet e rajonit.

Është e nevojshmë të bëhet e qartë sa më parë se kostoja e "gjysëm-Europës", kostoja e tejzgjatjes së procesit për pranimin e vendeve të tjera në BE, janë të konsiderueshme. Ky proces duhet të jetë i shkruar dhe i qartë me kushtet dhe afatet. Perspektiva e qartë e integrimit europian do të ketë efekte përfituese edhe për sigurinë rajonale dhe më gjerë në kontekstin gjeopolitik. Në terma afatgjatë, Europa do të quhet e kompletuar vetëm kur rajoni i Ballkanit të mos jetë më ajo "vrima e zezë në mes të Europës, të mos jetë më 'Balkan', por 'Balk-in'.[349]

Lista e shkurtimeve (Abreviations)

BE Bashkimi Europian
BP Ballkani Perëndimor
BiH Bosnja Hercegovina
IPA Instrumenti i Para Aderimit
MSA Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
OSCE Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Europian
PSA Procesi i Stabilizim Asociimit

Referencat

[1]. Braun, Aurel, (1983), *SMALL STATE SECURITY IN THE BALKANS*, Complications from the West, Palgrave Macmillan

[2]. Beshku, K., & Milori, D. (2018). *Shtetformimi, Demokratizimi & Europianizimi i Ballkanit Perendimor*. Tirana, Albania: Edlora

[3]. Dialogu Para – Antarësimit BE-Shqipëri, (2009), Ministria e Integrimit Europian, Sektori I Komunikimit, Tiranë, Shqipëri

[4]. European Commission (2018): *A credible enlargement perspective for and enhanced EU engagement with the Western Balkans*, COM (2018) 65 final, Strasbourg, 6 February, https://goo.gl/zyxEMJ

[348] Në vitin 2018 Komisioni Europian i komunikon Parlamentit Europian, Këshillit, Komitetit Ekonomik dhe Social Europian si dhe Komitetit të Rajoneve A credible enlargement perspective for and enhanced EU engagement with the Western Balkans, Strasbourg, https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf

[349] Marrë nga një diskutim i Ambasadorit Polak në Tiranë, Sh.T. Z. Karol Bachura, në një konferencë ndërkombëtare, 2017, Tiranë.

[5]. European Comission,(2018), CONNECTIVITY AGENDA *Co-financing of Investment Projects in the Western Balkans 201,* https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/connectivity-agenda-2018-sofia-summit.pdf
[6]. European Commission proposes new integration partnerships for the Western Balkans, IP/03/721. Internet: http://europa.eu/scadplus/leg/en/lvb/ r18008.htm, May 2nd 2006.
[7]. https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/connectivity-agenda-2018-sofia-summit.pdf
[8]. European Commission (Nov 2020): Remarks by Commissioner Várhelyi at the Berlin Process Foreign Ministers meeting, https://ec.europa.eu/commission/commissioners/2019-2024/varhelyi/announcements/remarks-commissioner-varhelyi-berlin-process-foreign-ministers-meeting_en
[9]. Florian Bieber and Nikolaos Tzifakis, (2019) The Western Balkans are drifting away from their Euro-Atlantic orientation, *The Western Balkans as a Geopolitical Chessboard? Myths, Realities and Policy Options,* Policy Paper, Balkans in Europe Policy Advisory Group, BiEPAG Policy Paper http://biepag.eu/wp
[10]. Gray, A.: 20/12/2000, *THE BALKAN IS STILL ENDANGERED*, SHEKULLI newspaper.
[11]. Konferenca për shtyp e Kryeministrit Edi Rama, Samiti i Triestes, Përfitimet e Shqipërisë në Procesin e Berlinit, https://kryeministria.al/newsroom/samiti-i-triestes-perfitimet-e-shqiperise-ne-procesin-e-berlinit-2/
[12]. KOMISIONI EVROPIAN,(6.10.2020), DOKUMENT PUNE I STAFIT TË KOMISIONIT, Raporti për Shqipërinë 2020 , Bruksel, SWD(2020) 354, version përfundimtar
[13]. INFORMATION NETWORK-SP Watch, 2000, Vol. 2, Issue 10, June 7
[14]. I Balkani senza Milosevic 5/2000, *Come cambia la Jugoslavia, I misteri del Kosovo, Una chance per l'Italia,* Limes, Rivista Italiana di Geopolitica
[15]. Ministria e Integrimit dhe Punëve të Jashtme (2021), *Historiku i Marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian- Datat dhe momentet historike*, http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/
[16]. Milo Paskal, 2002: BASHKIMI EUROPIAN, *Ideja, Integrimi, Identiteti, E ardhmja, Shtëpia Botuese "ALBPAPER*", Tiranë.
[17]. Mozali, Z. (2009). Integrimi Europian, *Bashkimi Europian, Ballkani, Shqipëria*, Shkodër, Albania: Camaj-Pipa.
[18]. Raporti për Shqipërinë i Komisionit Europian 2020, Brussels, 6.10.2020 SWD(2020) 354 final, tek https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf
[19]. Senghaas, Dieter, 2002, The realistic reconstruction by Westerners of their own historical development, *The clash within civilizations*, Routledge
[20]. SOUTH-EAST EUROPEAN INFORMATION NETWORK, Stability Pact Watch, Volume 2, Issue 10, June 7, 2000.
[21]. https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf
[22]. https://www.bankofalbania.org/rc/doc/ermelinda_132_1_12907.pdf